



RREGULLORE NR. 2002/9
LIDHUR ME NJË NDRYSHIM NË KORNIZËN KUSHTETUESE PËR
VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP-ja)

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë),

Pas shqyrtimit të komunikatës së Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 17 prill 2002 me anë të së cilës më 6 prill 2002 i është dorëzuar PSSP-së mocioni i miratuar nga Kuvendi me dy të tretat e shumicës së paraparë për ndryshimin e nenit 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme,

Duke vepruar në pajtim me nenin 14.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme,

Shpall ndryshimin në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të paraqitur në Shtojcën e kësaj Rregulloreje.

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 3 maj 2002.

Michael Steiner,
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCË

NDRYSHIMI I KORNIZËS KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME

Neni 9.1.7 i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme ndryshohet si vijon:

(i) Fjalja e parë në fillim duhet të jetë:

“9.1.7 Kuvendi do të ketë Kryesinë e përbërë nga tetë deputetë të Kuvendit të cilët do të zgjidhen si vijon”:

(ii) Pas nënparagrafit ekzistues (c) shtohet një nënparagraf i ri (d) si vijon:

“(d) Një anëtar do të emërohet nga partia ose koalicioni që ka fituar vendin e katërt me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare”;

(iii) Nënparagrafët ekzistues (d) dhe (e) do të rinumërohen si (e) dhe (f).

Rrjedhimisht, neni 9.1.7 që nga data 3 maj 2002 do të jetë si vijon:

“9.1.7 Kuvendi do të ketë Kryesinë e përbërë prej 8 deputetëve të Kuvendit të cilët do të zgjidhen si vijon:

(a) Dy anëtarë do të emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare;

(b) Dy anëtarë do të emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e dytë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;

(c) Një anëtar do të emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e tretë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;

(d) Një anëtar do të emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e katërt me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;

(e) Një anëtar do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb dhe

(f) Një anëtar do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb. Metoda për emërimin e këtij anëtari të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin komuniteteve të njëjta”.